

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"RAMKAJ DEVELOPMENT" sh.p.k**



Ne Tirane, sot me date 06 Shkurt 2018, u paraqit personalisht ortaku themelues:
Arben RAMKAJ, i biri i Feim e lindur me 13.06.1978 ne Elbasan, me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me Nr.personal H80613173Q,.
Deklaroj me vullnetin tim te plote e te singert dhe me iniciativen time te lire dhe private mbështetur ne kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe kodin civil ne fuqi,ne ligjin 9901 date 14.042008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ligjin 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, te krijoj shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar me emertim "SH.P.K

KREU I
Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti

Neni 1
Emertimi

Emertimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar eshte "**RAMKAJ DEVELOPMENT**" SH.P.K

Neni 2
Forma Juridike

Shoqëria "**RAMKAJ DEVELOPMENT**" sh.p.k është një shoqëri tregtare, e themeluar nga ortaku i shoqerise, i cili përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulone personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.
Ortaku gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

Neni 3
Selia

Selia ELBASAN Lagjja E RE, rruga Rinia, zona kadastrale 8524, pasuria nr.6/450-N.5, kati 2.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakut të Shoqërisë.

Neni 4
Objekti i veprimtarise

Shoqeria do te kryeje aktivitetin e meposhtem(vetem nese eshte i përcaktuar

Agjensi imobiliare,komisioniere. Sherbime shitje, blerje pasurive te paluajtshme toka bujqesore, are ,troje, ndertesa, dhe martja e tyre me qera .(Real Estate). Ndertim i banesave ne pergjithesi, qendresh biznesi,fshatrave turistike etj .,

Imp-Eksport e tregtim me shumice e pakice brenda e jashte vendit te gjithë llojeve te materialeve

te ndertimit, industriale, blegtoriale, drusore, mjekesore, farmaceutike, te gjithë instrumentave te makinerive. Sherbime spitalore, klinika shendetsore.

Ne fushen e prodhimit bujqesor dhe ne marketing, te prodhojne, te perpunojne, te ruaje, te klasifikojë, te transportoje, te shperndaje, si dhe te tregtoje produktet buqesore ose blegtorale ne gjendjen e tyre natyrale ose te perpunuar me pare. Blerje, perpunim, prodhim dhe fabrikim me cfardo lloj procesi ushqime per bagetina, plehra kimike, bime, farera, produkte fitosanitare, materiale, instrumente, makineri, impiante, produkte me prejardhje nga kafshet dhe cfardo lloj produktesh te tjera te nevojshme dhe te pershtatshme per zhvillimin e prodhimit, bujqesor dhe blegtoral. Agrobiznes, biznes i prodhimit bujqesor, shperndarjes, makineri bujqesore, perpunimit dhe furnizimit fara, si dhe marketingut dhe te 2 shitjes me pakice. Shitje te makinerive bujqesore dhe pjeseve te kembimit per to.

Hapje te agjencive turistike e udhetimesh, komisioner
Qender kurative termale, trajtime termale, perfshire terapi te ndryshme me uje natyral termal dhe balte termale, sesione fizioterapie dhe masazhe terapie. ofrim te te gjithë sherbimeve me karakter terapeutik nen kontrollin, kujdesin dhe rekomandime te doktorit

Ne fushen e arsimit, kultures, edukimit, formimit, kerkimit dhe aplikimit shkencor. Krijimin dhe ngritjen sasiore e cilesore te institucioneve perkatese arsimore, kulturore, edukative dhe shkencore te shkalleve e niveleve sipas dispozitave ligjore ne fuqi. Sherbime edukative dhe sociale. Trainime ne qendrat e miratuara. Çdo aktivitet i lejuar me ligj..

Neni 5 **Kohezgjatja**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne regjistrin tregtar. Shkurtimi i kesaj kohezgjatje ne rastin e nje prishje te persheptuar te shoqerise ose zgjatja e afatit, duhet te behet me vendim te Ortakut të Vetëm të Shoqërisë

KREU II **KAPITALI**

Neni 6 **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 lekë (njqind mije leke). Pjesemarrja e themeluesit ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributit e tij .

Personi zotëron 100% të kapitalit në shoqëri si ortak i vetëm.

Kapitali eshte i korespondon nje 1 kuote te vetme me vlere 100.000leke (njqintemije leke) .

Kontributi i ortakeve mund te jete ne para ose ne natyre.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësive mbi kuotën si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata për kalimin e kuotës hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përben kusht për vlefshmerinë apo regjistrimin e kontratës. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palet bien dakort në kontratë, vlefshmeria e kalimit të titullit të pronësive mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit”.

KREU III

ORGANET VENDIMARRRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimarrës

Ortaku i vetëm është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë.

Ortaku i vetëm është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të percaktuara në ligj. Ortaku i vetëm është përgjegjës për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9 **Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës për çështje të tjera si:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shperblimeve,
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykate dhe në procedimet e tjera ndaj administratoreve,
- f) miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblese

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Neni 10 **Administrimi**

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.


(3) Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Të dhënat e identifikimit: dhe specimenët e nënshkrimit:

Administratori i shoqërisë do të jetë Arben RAMKAJ, lindur më 13/08/1976, në Elbasan, identifikuar me nr. personal H80613173Q.

Neni 11

4



Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatit dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të percaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakeve edhe në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkuar brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar,

Nëse asambleja e përgjithshme emeron me shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkarisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme, mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë, me shumicë të zakonshme. Padite që lidhen me shpërblimin e administratorit në baze të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 12

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përkrahimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 13

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

5



ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";

d) me vendim të gjykatës;

Në këte rast Ortaket marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë menyren e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqëri në likuidim e sipër ". Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 14

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin në përputhje të plote me këte akt themelimit statutin dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 15

Mosmarreveshjet

Për mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tjerëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Ortaku i vetëm i shoqërisë si themelues i saj pasi e lexoi me vëmendje akt themelimit e mesipër dhe duke qenë konform vullnetit të tij e firmosi pa vërejtje.

ORTAKU THEMELUES I SHOQËRISË "RAMKAJ DEVELOPMENT" sh.p.k

Arben RAMKAJ

Arben Ramkaj